



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 29 dhjetor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1640_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ndrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike, të dorëzuar me datë 17 tetor 2022, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Termike me dokumentacionin relevant sqarues,

në seancën e mbajtur me datë 29 dhjetor 2022, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (në tekstin e mëtejme: MAR) në vlerën 839,755€ për ndërmarrjen NQ Gjakova SH.A., që do të mblihdhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2022/2023.**
- II. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos SH.A.**
- III. Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Termokos SH.A., duke filluar nga data e fillimit të sezonit të ngrohjes 2022/2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.**

A R S Y E T I M


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 17 tetor 2022 nga NQ Gjakova SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që ndërmarrjes i lejohet të mbledhë nga tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR), ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara në aplikacionin preliminarë të dorëzuar nga NQ Gjakova me dt. 23 gusht 2022;
 - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 23 shtator 2022, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara në aplikacionin preliminarë;




- Aplikacioni me të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Gjakova SH.A. me datë 17 tetor 2022;
 - Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Gjakova SH.A.– sezoni i ngrohjes 2022/2023;
 - Gjatë periudhës së konsultimit publik (12 – 27 dhjetor 2022), ZRRE nuk ka pranuar ndonjë koment;
 - Raportin Final për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Gjakova SH.A. – sezoni i ngrohjes 2022/2023.
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranura nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Bashkangjitur: Raporti Rregullativ: Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara për NQ Gjakova sh.a. – sezoni i ngrohjes 2022/2023

Vendimi i dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së